

VENDIM
Nr. 204, datë 10.8.2022

MBI SHTYRJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s PËR APLIKIMIN E SHOQËRISË “ALBPETROL” SHA PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3, dhe nenit 16, pika 6, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.8.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1439/3 prot., datë 8.8.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Albpetrol’ sh.a. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 179, datë 13.7.2022 vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Albpetrol” sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë.

- Në vijim, ERE ka dërguar njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës, i cili është botuar në datat 15.7.2022 dhe 16.7.2022 dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga palët e treta (data e fundit 28.7.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla. Ndërsa me shkresën nr. 971/7 prot., datë 27.7.2022, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimmarrjen e mësipërme të Bordit, duke evidentuar dhe dokumentacionin e munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Me e-mailin e protokolluar në ERE me nr. 971/2 prot., datë 8.8.2022, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të këtij aplikimi, duke u angazhuar që dokumentacionin e depozituar të skanuar nëpërmjet këtij e-maili do ta depozitojë në ERE zyrtarisht dhe në formën e kërkuar nga ligji. Po ashtu shoqëria ka deklaruar se do të depozitojë dokumentacion shtesë të këtij aplikimi brenda 5 ditëve.

- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, është parashikuar dhe zgjatja e këtij afati rasti pas rasti, konkretisht:

3. Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit të përcaktuar në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë pune.

- Afati i vlefshmërisë së licencës për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. përfundon më datë 6.9.2022, ndaj ERE-s kushtëzohet për të shtyrë afatin e vendimmarrjes deri në afatin e fundit të vlefshmërisë së licencës.

- Me qëllim që të shqyrtohet dokumentacioni i depozituar nga ana e shoqërisë e t'i jepet asaj mundësia për të plotësuar dhe pjesën tjetër të dokumentacionit, vlerësohet shtyrja deri më datë 6.9.2022 i afatit të vendimmarrjes së Bordit mbi kërkesën e shoqërisë “Albpetrol” sh.a. për rinovimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria duhet të plotësojë të gjithë dokumentacionin brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja dijeni e vendimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shtyjë deri më 6.9.2022 afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “Albpetrol” sh.a. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Shoqëria duhet të plotësojë të gjithë dokumentacionin brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti